



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0734

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE ALBI COMPANY SH.P.K, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit 109 Renovimi i Shkollave Filllore – Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli”, me numër të prokurimit 616-25-4319-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 25.09.2025, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e ALBI COMPANY SH.P.K., me nr. 2025/0734, e datës 04.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit 109 Renovimi i Shkollave Filllore – Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli”, me numër të prokurimit 616-25-4319-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, për aktivitetin e prokurimit “109 Renovimi i Shkollave Filllore – Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli”, me numër të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.05.2025 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit 109 Renovimi i Shkollave Filllore – Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli”, me numër të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, , lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **82,965.07 Euro**.

Me 14.07.2025 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), për aktivitetin e prokurimit 109 Renovimi i Shkollave Filllore – Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli”, me numër të prokurimit 616-25-4319-5-2-1, ku ka shpërblyer me kontratë GOE ART - EDA SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K.

Me 21.07.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 24.07.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.08.2025, OE **ALBI COMPANY SH.P.K.**, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0734, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ALBI COMPANY SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

AK-së ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim duke na konsideruar neve si OE pa interes, ku ne si OE nuk pajtohemi me përgjigjen e AK sepse në pikat ankimore ku kemi argumentuar që kemi OE palë interesi pasi që jemi me çmim më të lirë dhe i përgjegjshëm ku kemi dorëzuar dokumente, Certifikatën për hidroizolim për Inxhinierin e ndërtimtarisë e cila është e barazvlefshme, po ashtu kemi dorëzuar dëshmuar dëshmitë mbi pajisjet në pajtueshmëri me LPP dhe Rregulloren, Udhëzuesin që janë në fuqi. AK-së edhe në kriter ka përshkruar se mund të verifikohen dokumentat në origjinalitet. Ku ne si OE jemi të gatshëm në rivlerësim me dorëzuar të gjitha dokumentat origjinale.

AK në asnjë rrethanë nuk ka ofruar përgjigje ndaj pikave ankimore të cilët kemi argumentuar me fakte që OE konkurrues është i papërgjegjshëm, ku OE fitues nuk ka dorëzuar vërtetimin mbi vepër penale për pronarët e grupit të OE që nënkupton se të njëjtit sipas LPP duhet hyjnë në listën e zezë të OSHP-së. OE fitues është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara si kamionetën, marrëveshja për qira të pajisjeve nuk plotëson kushtet ligjore të marrëveshjes sepse në këtë marrëveshje nuk janë të përshkruar se cilat pajisje kontraktohen ndërmjet palëve. OE fitues konsiderohet konflikt interesi pasi që Drejtori z. Mulaj si drejtor i

prokurimit në AMKMK ka përdorur dokumentat e kompanisë Loni si stafin profesional, pajisjet etj. ku kompania LONI shpk ka kontrata aktive me AMKMK.

Neni 1 Qëllimi Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Ju si AK-së keni shpërblyer me këtë aktivitet të prokurimit OE i cili është më i shtrenjti sipas procesverbalit të hapjes. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi. Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përputhshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare. Neni 26 Paragrafi 26.16 Rregullorja 001/2022 ndryshuar plotësuar me Rregulloren 002/2024

Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti / personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme. 25.5 Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzojë në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Nuk keni bërë vlerësim në pajtueshmëri me LPP.

OE FITUES I PËRGJEGJSHËM

Pika ankimore nr. 1: Te kërkesa 1 pika 3 është kërkuar si dëshmi: Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori Ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk është shpallë fajtor nga një Gjykatë Kompetente për kryerjes e një veprë penale. Sipas qasjeve në dokumenteve të GR OE të njëjtin nuk kanë dorëzuar VERTETIM nga Gjykata për pronarët e kompanisë të Art-Eda shpk si Lider por as për anëtarin e Konsorciumit H&S Partners Group shpk. AK-së në kundërshtim me LPP keni shpërblyer me këtë aktivitet të prokurimit GR OE fitues ofruar dëshmi Vërtetimet nga Gjykata për pronarët e kompanisë. Ku në dosje tenderit përshkruhet qartë se mos dorëzimi i këtyre dokumenteve atëherë AK do të refuzojë tenderin dhe do të ndërmarrë masa ligjore sipas nenit 99.2 LPP-së. Të bashkëngjitur Procesverbalin e pranimit të dokumenteve ku është përshkruar, ku zyrtari i prokurimit deklaron se janë të ngarkuar të gjitha dokumentat e tre OE konkurrues.

Pika ankimore nr. 2: Sipas Certifikatës së regjistrimit në ARBK konstatohet se Besim Mulaj është pronar i kompanisë Z. Mulaj është drejtor i Prokurimit në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës – AMKMK. Sipas dokumenteve të dorëzuar nga GR OE i cili është shpallë përfitues se këtij aktiviteti ne si OE ankues kemi hasur që i njëjti GR OE ka

përdorur dokumentat e stafit profesional, teknik dhe mbështetës të kompanisë LONI shpk. Ku sipas CV-ve, Referencat e tyre përshkruhet se njëjtin SE JANË TË PUNËSUAR AKTIV tek OE LONI shpk siç janë këta persona: z. Musli Kuteshi – Inxhinier i Ndërtimtarisë Konstruktiv, Emir Bunjaku Inxhinier Arkitekturës, z. Mirsim Maloku – Bachelori i Emergjencave, sipas Shemsi Maloku – Teknik i ndërtimtarisë, Arsim Maloku – Zdruktharë, Ferat Maloku – Armues, Ragip Latifi – Mjeshtër, Vehbi Jetullahu – Armues. Nëse si OE konsiderojmë KONFLIKT INTERESI nëse i njëjti staf i lartcekur është përgjegjës për ekzekutimin e kontratave të cilët OE Loni shpk i ka aktive me AK-së AMKMK ku drejtor i prokurimit është z. Mulaj. Nëse vërtetohet, ku kërkojmë që vërtetohet se OE Loni shpk posedon kontrata aktive me AK-së AMKMK dhe nëse OE Loni shpk e angazhon të njëjtin staf për ekzekutim të kontratave aktive me AMKMK, atëherë e paarsyeshme çka të vazhdojmë më tutje përveç që ta angazhoni nga AK-së KK Prishtinë dhe OSHP – POLICINË E KRIMEVE EKONOMIKE për hetim. Si OE kemi kërkuar ana e juaj si Zyra e prokurimit që të kërkonin në KRPP ose në AMKMK se OE Loni shpk Prishtinë a ka kontrata aktive me AMKMK dhe nëse po sa kontrata aktive i posedon dhe a është i njëjti staf i angazhuar në këto kontrata sepse sipas Referencave të këtyre të punësuar cekën kontrata që OE Loni ka qenë çdo herë OE kontraktues me AMKMK ku z. Mulaj është drejtor i prokurimit. AK-së nuk ka ndërmarrë asnjë veprim mbi këtë çështje të vërtetimit të pikës ankimore nga ana jonë si OE ankues.

POR: Nëse si OE përmes e-prokurimit kemi hasur së paku tri kontrata aktive që OE LONI shpk i ka të kontraktuara me AK-së AMKMK. Gjini të BASHKËNGJITURA. Për këtë çështje kemi kërkuar përmes email se a konsiderohet KONFLIKT INTERESI ky rast të cilën e ka praktikuar z. Mulaj.

Pika ankimore nr. 3: Sipas informatave të kompanisë tonë z. Emir Bunjaku me profesion Inxhinier i Arkitekturës. Ku i njëjti ende vazhdon të punojë në Ndërmarrjen Publike Banesore. Ku Ndërmarrja Publike Banesore – NPB është ndërmarrje publike e Komunës së Prishtinës – Komuna e Prishtinës është aksionar 100% e NPB. Nëse si OE konsiderojmë KONFLIKT INTERESI angazhimin e z. Emir Bunjakut nga kompania Art/Eda shpk për këtë aktivitet prokurimi ku kontraktues se aktivitetit është Komuna e Prishtinës ku z. Bunjaku është i angazhuar si i punësuar aktiv i Komunës së Prishtinës, duke u bazuar se NPB është ndërmarrje publike e Komunës Prishtinë e cila sipas Formularit Standard për rishqyrtim të vendimit në AK 4/3 posedon 100% aksionet e NPB. Është jologjore që i punësuar aktiv i Komunës së Prishtinës të angazhohet nga Gr OE fitues si i punësuar për aktivitetet e prokurimit / kontratë të Komunës së Prishtinës. Këtë pikë kemi kërkuar nga Agjencia Kundër Korrupsion që ta vërtetojë se a është konflikt interesi që z. Bunjaku.

Pika ankimore nr. 4: Dokumenti Marrëveshje për qira të mjeteve dhe pajisjeve i datës 04.06.2025 i lidhur ndërmjet anëtarit të grupit H&S Partners Group shpk dhe Gal Group shpk në asnjë nen të marrëveshjes nuk janë përshkruar se cilat pajisje/makineri i kontraktojnë palët. Dokumenti Marrëveshje për qira të mjeteve dhe pajisjeve i datës 04.06.2025 i lidhur ndërmjet anëtarit të grupit H&S Partners Group shpk si huamarrës dhe Loni shpk si huadhënës në asnjë nen të marrëveshjes nuk janë përshkruar se cilat pajisje/makineri i kontraktojnë palët. Që si OE pretendojmë se këto marrëveshje nuk përmbushin kushtin kontraktual ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit sepse në çdo marrëveshje ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit duhet përshkruhet se cila pajisje merret me qira. Si argument OE fitues Art-Eda shpk në dokumentin LISTA E MAKINERISË DHE MJETEVE TË PUNËS, STABILIMENTEVE DHE PAJISJEVE TEKNIKE, ku në PIKËN 2 TË LISTËS SË PAJISJEVE është i përshkruar me numër tabelave KAMIONET Volkswagen 01-7523-NL, ku për këtë pajisje ka ofruar Librezën e pajisjes tjetër

KAMIONET me numër tabelave 01-714-PM. Kjo argumenton se marrëveshja e dorëzuar nga Gr OE fitues nuk i plotëson kushtet kontraktuale ligjore ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit. Kushtet kontraktuale i nderuar z. Shehu nëse shkon tek Noteri për ta bërë një kontratë mbi qiranë e një lokali, Noteri nuk bën asnjë marrëveshje / kontratë kontraktuale ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit pa përcaktuar/specifikuar se cili lokal jepet me qira.

OE ENGINEERING – Pika ankimore nr. 1 PA PËRGJEGJSHËM Kamioni me kran me nr. tab: 06-185-CU është me peshë mbartëse 5.22 Ton, ndërsa në F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK 5/3 kërkesë është kërkuar Pesha mbartëse 7-9 Ton. – Po ashtu afati i regjistrimit nuk mund të shikohet sepse është i padukshëm.

ALBI COMPANY I PËRGJEGJSHËM pasi që jemi me çmim më të lirë se OE fitues dhe kemi dorëzuar të gjitha dokumentat që janë në pajtueshmëri me kërkesat dhe rregulloren, udhëzuesin, LPP. Në pikën 2.3 të kërkesës 2 NGA AK-së keni kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, të jetë i certifikuar APO të ofrojë dëshmi mbi Trajnimet të kryera nga prodhuesit për sistemet hidroizoluese kristalizuese, riparuese dhe mbrojtjes min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit. AK-së në përshkrimin e kriterit keni lënë dy mundësi që Inxhinieri i diplomuar i Ndërtimtarisë të jetë i Certifikuar APO të ofrojë dëshmi mbi trajnimet sepse vet përshkrimi i fjalës APO nënkupton dy mundësi.

Ne si OE kemi dorëzuar Inxhinier Ndërtimtarie – Hidro ku kemi bashkëngjitur Certifikatën e Trajnimit për Hidroizolim. Andaj Certifikata e dorëzuar nga ne si OE për inxhinierin është sipas standardeve për Hidroizolim e cila është e njëjtë, e barazvlefshme, ekuivalente me kërkesën. Në trajnime mësohet standardet e hidroizolimit, procedura e përdorimit, karakteristikat e materialeve hidroizoluese, specifikat e materialeve hidroizoluese.

Andaj certifikata është e vlefshme për ju si AK-së kjo certifikatë nëse përmbushë kërkesën për sistemet hidroizoluese dhe është në pajtueshmëri me kërkesën e përshkruar. Certifikata e dorëzuar është në pajtueshmëri me paragrafin 26.6 të nenit 26 Rregullores 001/2022 ndryshuar plotësuar me rregulloren 002/2024 pasi që kjo certifikatë përmbushë standardet të caktuara të cilësisë që bazohen në standarde europiane ose ndërkombëtare.

Andaj kërkesa e juaj nuk është në përputhje me paragrafin 25.5 nenit 25 Rregullores 001/2022 të plotësuar ndryshuar me rregulloren nr. 002/2024. Kompanitë prodhuese nuk kanë bazë ligjore që të ofrojnë certifikatë sepse nuk janë shkollë të Licencuar nga ana e Shtetit për të Certifikuar Inxhiniera apo staf tjetër. Kompanitë prodhuese ofrojnë vërtetim për pjesëmarrje mbi ndonjë organizim që prezantojnë specifikimet e produkteve dhe procedurën e përdorimit të tyre gjatë implementimit. Ju si AK-së gjatë përpilimit të dëshmisë për kërkesën nr. 3 keni lënë mundësinë sepse keni përdorur fjalën OSE vetëm tek Deklarata Unike Doganore keni kërkuar kopje të noterizuar nga origjinali për dëshmitë e kërkuara. Ku komisioni vlerësues në përshkrimin e vlerësimit të njoftim vendimit të AK-së e ka bërë ndryshimin e kriterit të cilën nuk është kërkuar siç përshkruhet në eliminim. Për pajisjen e kërkuar 3.3 Mjet vetëshkarkues damper min 2m3 ne si OE kemi dorëzuar Dudin R9630 të noterizuar me peshë 2800kg dhe Dudin R7784 të noterizuar – ku në përshkrim shkruan qartë – PAJISJE PËR LËVIZJE JASHTË RRUGËS – që nënkupton se kjo pajisje me ligj nuk regjistrohet apo si eskavatori, ngarkuesi, etj. që janë pajisje ndërtimore brenda vendpunishtes nuk kërkohet me ligj që të regjistrohen. Për secilën pajisje ne si OE kemi dorëzuar Faturën e Noterizuar ose Faturën me fletëpagesë nga Banka që argumenton dhe vërteton vërtetësinë e faturës së blerjes. AK-së ka në dëshmi FTD ka përshkruar se AK-së mund t'i verifikojë vlefshmërinë e dokumenteve të dorëzuar ku AK-së në kundërshtim me LPP nuk ka

kërkuar nga ne si OE konkurrues që t'ia argumentojmë vlefshmërinë duke ju ofruar faturat, dudat në ORIGINAL. Ku ne si OE jemi të gatshëm në rivlerësim t'ia argumentojmë dokumentat original. AK-së nuk ka qenë në dijeni që OE në të kaluarën sipas Ligjit kanë mund me bërë blerje deri 500 euro duke bërë pagesën Cash, ndërsa tani OE mund të blejnë deri 300 Euro duke paguar në Cash, apo blerjet me kupon fiskal që bëjnë pagesat CASH. Por mbi të gjitha si ju AK-së në kundërshtim me NENIN 26 PARAGRAFI 26.16 RREGULLORJA 001/2022 NDRYSHUAR PLOTËSUAR ME RREGULLOREN 002/2024 nuk keni pasur të drejtë ligjore që të kërkonit kopje të noterizuar pasi që paragrafi 26.16 ju ka ndaluar rreptësisht që kërkohej dokumentat kopje të noterizuar. Andaj këtë shqetësim do ta paraqes edhe pranë KRPP që të ndërmerren masa ligjore ndaj jush si Zyra e prokurimit që keni vazhduar që ta mos respektoni Rregulloren nr. 001/2022 të ndryshuar dhe plotësuar nr. 002/2024.

Ne si OE të gjitha dokumentat e pajisjeve i kemi dorëzuar në pajtueshmëri me nenin 26 paragrafin 26.16 Rregulloren 001/2022 të ndryshuar nr. 002/2024. Neni 26 Paragrafi 26.16 Rregullorja 001/2022 ndryshuar me Rregulloren 002/2024 – dyshimit të cilido informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit do të kryejë kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: "Operatori ekonomik "Abi Company shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 21.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës "Qamil Batalli" me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pika ankimore nr. 1: Te kërkesa 1 pika 3 është kërkuar si dëshmi; një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a) Operatori Ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk është shpallë fajtor nga një Gjykatë Kompetente për kryerjen e një veprë penale. Sipas qasjeve në dokumentet e GR OE të njëjtin nuk kanë dorëzuar vërtetim nga Gjykata për pronarët e kompanisë Art-Eda shpk si lider por as për anëtarin e Konsorciumit H&S Partners group shpk. Ju si AK-se, në kundërshtim me LPP, keni shpërblyer me këtë aktivitet të prokurimit GR OE fitues pa ofruar dëshmi - vërtetimet nga Gjykata për pronarët e kompanisë. Ku në dosjen e tenderit përshkruhet qartë se mosdorëzimi i këtyre dokumenteve atëherë AK do të refuzojë tenderin dhe do të ndërmarrë masa ligjore sipas nenit 99.2 LPP-së.

Pika ankimore nr. 2: Sipas Certifikatës së regjistrimit në ARBK konstatohet se Besim Mulaj është pronar i kompanisë. Z. Mulaj është drejtor i Prokurimit në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës - AMKMK. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga GR OE i cili është shpallur përfitues i këtij aktiviteti, ne si OE ankues kemi hasur që i njëjti GR OE ka përdorur dokumentet e stafit profesional, teknik dhe mbështetës të kompanisë LONI shpk. Sipas CV-ve dhe referencave të tyre përshkruhet se të njëjtit janë të punësuar aktivisht tek OE LONI shpk siç janë: z. Musli Kuteshi – Inxhinier i Ndërtimitarisë Konstruktive, Emir Bunjaku – Inxhinier Arkitekture, z. Mirsim Maloku – Bachelor i Emergjencave, Shemsi Maloku – Teknik i

Ndërtimtarisë, Arsim Maloku – Zdrukthtar, Ferat Maloku – Armues, Ragip Latifi – Mjeshtër, Vehbi Jetullahu – Armues. Ne si OE konsiderojmë konflikt interesi nëse i njëjti staf i lartcekur është përgjegjës për ekzekutimin e kontratave të cilat OE LONI shpk mund t'i ketë aktive me AK-në AMKMK, ku drejtor i prokurimit është z. Mulaj. Nëse vërtetohet, kërkojmë që të konfirmohet nëse OE LONI shpk posedon kontrata aktive me AMKMK dhe nëse po, sa kontrata aktive i posedon dhe a është i njëjti staf i angazhuar në këto kontrata. Sipas referencave të këtyre të punësuarve ceket se OE LONI ka qenë çdo herë OE kontraktues me AMKMK ku z. Mulaj është drejtor i prokurimit. Nëse vërtetohet, atëherë është e paarsyeshme të vazhdohet më tej përveç që të angazhohet nga ju si AK-ja e Komunës së Prishtinës Policia e Krimeve Ekonomike për hetim.

Pika ankimore nr. 3: Sipas informacioneve të kompanisë sonë, z. Emir Bunjaku me profesion Inxhinier i Arkitekturës ende vazhdon të punojë në Ndërmarrjen Publike Banesore (NPB). NPB është ndërmarrje publike e Komunës së Prishtinës, ku Komuna është aksionar 100%. Ne si OE konsiderojmë konflikt interesi angazhimit të z. Emir Bunjakut nga kompania Art-Eda shpk për këtë aktivitet prokurimi, ku kontraktues është Komuna e Prishtinës, ndërsa z. Bunjaku është i angazhuar si i punësuar aktiv i Komunës së Prishtinës. Është joligjore që një i punësuar aktiv i Komunës së Prishtinës të angazhohet nga GR OE fitues si i punësuar për aktivitete prokurimi/kontrate të Komunës së Prishtinës.

Pika ankimore nr. 4: Dokumenti “Marrëveshje për qira të mjeteve dhe pajisjeve” i datës 04.06.2025 i lidhur ndërmjet anëtarit të grupit H&S Partners Group shpk dhe Gal Group shpk nuk përmban specifikime se cilat pajisje/makineri kontraktjnë palët. Po ashtu, marrëveshja e qirasë e lidhur ndërmjet H&S Partners Group shpk si huamarrës dhe Loni shpk si huadhënës nuk përmban specifikime të qarta për pajisjet. Kjo, sipas nesh si OE, nuk përmbush kushtin kontraktual pasi çdo marrëveshje duhet të specifikojë qartë pajisjet që jepen me qira. Për më tepër, në listën e pajisjeve të dorëzuar nga Art-Eda shpk në pikën 2 është përshkruar me numër tabelash kamioneti Volkswagen 01-7523-NL, por është ofruar librezë për një kamionet tjetër me nr. 01-714-PM. Kjo tregon se marrëveshja e dorëzuar nga GR OE fitues nuk i plotëson kushtet kontraktuale.

ARSYETIMI I ELIMINIMIT TË PARASHTRUESIT „Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar për këto arsye: Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë (pika 2.3): është kërkuar të jetë i certifikuar nga prodhues për sistemet hidroizoluese, kristalizuese, riparuese dhe mbrojtëse, me min. 3 vite përvojë pas diplomimit. Grupi nuk ka ofruar dëshmi të certifikimit nga prodhues, por vetëm një certifikatë nga kompani e shërbimeve të menaxhimit, jo prodhues. Nuk plotëson kërkesën e AK-së. Mjet vetëshkarkues (damper) min. 2 m³ – së paku 1 copë (pika 3.3): është kërkuar kopje e librezës valide të qarkullimit si dëshmi. OE nuk ka ofruar këtë, por vetëm faturë blerjeje dhe dokument doganor. Nuk plotëson kërkesën. Për disa pajisje të tjera (mjet ngritës me kovë, hilti për demolim, përzierës ngjitës, thithëse elektrike, rrafshuese gleti) nuk janë dorëzuar faturat e noterizuara bashkë me dëshmi pagese sipas kërkesës së DT. Nga shqyrtimi është gjetur se: Parashtruesi nuk i konteston arsyet e eliminimit dhe e pranon se ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Rrjedhimisht eliminimi i tij është i drejtë. Përderisa vetë është i papërgjegjshëm, nuk mund të trajtohet si palë interesi sipas nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP-së. Pavarësisht kësaj, oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur në përputhje me kërkesat dhe specifikat e DT-së.

Përfundim: Pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara dhe kërkesa për rishqyrtim është refuzuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12.08.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0734, ndërsa me datë 18.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0734, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEALBI COMPANY SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0734 ka vlerësuar si në vijim: Sipas OE supozohet se janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. si në vijim: Neni 1 Qëllimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasitet Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përputhshmërinë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. NENI 26 PARAGRAFI 26.16 RREGULLORJA 001/2022 NDRYSHUAR PLOTESUAR ME RREGULLOREN 002/2024 25.5 Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzojë në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Nuk keni bërë vlerësim në pajtueshmeri me LPP.

Pretendimi i 1 OE “ “OE “ALBI COMPANY” SH.P.K”- Prishtinë SH.A-Prishtinë Pika ankimore nr 1: Ke kërkesen 1 pika 3 është kërkuar si dëshmi; Nje vertetim nga Gjykata qe verteton se a. Operatori Ekonomik, ndonje drejtues, menaxher ose drejtor I saj gjate dhjete viteteve te kaluara nuk eshte shpalle fajtores nga nje Gjykate Kompetente per kryerjes e nje vepre Penale. Sipas qasjeve ne dokumenteve te GR OE te njejtin nuk kan dorezuar VERTETIM nga Gjykata per pronaret e kompanise te Art-Eda shpk si Lider por as per anetarin e Konsorciumit H&S Parners group shpk. AK-se ne kundërshtim me LPP keni shpërblyer me kete aktivitet te prokurimit GR OE fitues ofruar dëshmi Vertetimet nga Gjykata per pronaret e kompanise. Ku ne dosje tenderit pershkruhet qarte se mos dorezimi I ketyre dokumenteve atëherë AK dote refuzoje tenderin dhe dote ndermarrë masa ligjore sipas nenit 99.2 LPP-se , Te bashkëngjiture Procesverbalin e pranimit te dokumenteve ku eshte pershkruar, ku zyrtari i prokurimit deklarone se jane te ngarkuar te gjitha dokumentat e tre OE konkurrues.

Përgjigje në Pretendimin 1 OE “ALBI COMPANY” SH.P.K”- Prishtinë: Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje të Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë ka kërkuar Operatori Ekonomik

duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>

1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-42, Plotësimi i Aneksit Nr. 2 të Dosjes së Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjelle dokumentet të kërkuara në piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është listuar në vendin e dytë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit dhe të ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomik fitues, Grup i Operatorëve Ekonomik ART - EDA SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Hakif Zejnullahu Hoteli i Vetmuarve, Nr 4-1, 10000, Prishtinë, Kosovë konstatohet se në pikën përkatëse të FDT-së janë paraparë këto kërkesa për operatorin ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe që duhet të dorëzohen para publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së: Nga shqyrtimi i dokumenteve rezulton se Grupi i OE Grup i Operatorëve Ekonomik ART - EDA SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Hakif Zejnullahu Hoteli i Vetmuarve, Nr 4-1, 10000, Prishtinë, Kosovë fitues ka dorëzuar: Deklaratën nën betim të nënshkruar nga drejtori/proprietari i kompanisë lider, ku ky i fundit ka konfirmuar përmbushjen e kriterëve të përshtatshmërisë si për entin juridik, ashtu edhe për veten në cilësinë e “drejtorit/drejtuesit”; Vërtetimin nga Gjykata për kompaninë (OE), e cila në këtë rast përfaqësohet dhe administrohet nga i njëjti person (pronari/drejtori); Dokumentet e tjera sipas pikave 1 dhe 2 të FDT-së. Duke qenë se personi fizik (pronari/drejtori) është i njëjti që përfaqëson shoqërinë tregtare, deklarata nën betim e tij, së bashku me vërtetimin gjyqësor për OE, në këtë rast mbulon kërkesën e FDT-së për “operatorin ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor”. Prandaj, në interpretimin e ekspertit shqyrtues, AK ka vepruar në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe me nenin 65 të LPP-së, pasi dokumentacioni i dorëzuar është i mjaftueshëm për të vërtetuar mosdënimin penal dhe gjendjen ligjore të OE dhe drejtuesve të tij. Në këto raste nuk është e nevojshme lëshimi i një vërtetimi të veçantë individual për drejtuesin, për sa kohë ai është i identifikuar dhe përfaqëson formalisht OE-në në të gjitha aktet e tenderit. Ekspertit shqyrtues mendon se, AK ka vepruar në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe me nenin 65 të LPP-së, pasi dokumentacioni i dorëzuar është i mjaftueshëm për të vërtetuar mosdënimin penal dhe gjendjen ligjore të OE dhe drejtuesve të tij.

Eksperti Shqyrtues Thekson se Pretendimi i OE Prishtinë ankues gjendet i PA BAZUAR

Pretendimi 2 i OE “ALBI COMPANY” SH.P.K”- “Kërkesa në FDT që Pika ankimore nr 2: Sipas Certifikates se regjistrimit ne ARBK konstatohet se Besim Mulaj eshte pronar I kompanise. Z Mulaj eshte drejtor I Prokurimit ne Agjencin per Menaxhimin e Komplekseve

Memorialeve te Kosoves AMKMK. Sipas dokumenteve te dorezuar nga Gr OE I cili eshte shpalle perfitues se ketij aktiviteti ne si OE ankues kemi hasur qe I njejt GR OE ka perdore dokumentat e stafit profesional, teknik dhe mbeshtetes te kompanise LONI shpk. Ku sipas CV-ve, Referencat te tyre pershkruhet se njejtin SE JANE TE PUNESUAR AKTIV tek OE LONI shpk siq jane keta persona: z.Musli Kuteshi -Inxh Ndertimtarise Konstruktiv, Emir Bunjaku Inxh Arkitektues z. Mirsim Maloku - Bachelor i Emergjencave sipas Shemsi Maloku- Teknik i ndertimtarise, Arsim Maloku – Zdrukthare, Ferat Maloku Armues, Ragip Latifi- Mjeshter, Vehbi Jetullahu-Armues. Ne si OE konsiderojme KONFLIKT INTERESI nese I njejt stafi I lartecukur eshte pergjegjes per ekzekutimin e kontratave te cilet OE Loni shpk i ka aktive me AK-se AMKMK ku drejtor I prokurimit eshte z,Mulaj.

Nese vertetohet, ku kerkojme qe vertetohet se OE Loni shpk posedon kontrata aktivite me AK-se AMKMK dhe nese OE Loni shpk e angazhon te njejten staf per ekzekutim e kontratave aktivite me AMKMK, atehre e pa arsyeshme cka te vazhdojme metutje perveq qe ta angazhoni nga AK-se KK Prishtine dhe OSHP - POLICINE E KRIMEVE EKONOMIKE per hetim. Si OE kemi kerkuar ana e juaj si Zyre e prokurimit qe te kerkoni ne KRPP ose ne AMKMK se OE Loni shpk Prishtine a ka kontrata aktive me AMKMK dhe nese po sa kontrata aktive I posedon dhe a eshte I njejt staf I anagzhuar ne keto kontrata sepse sipas Referencave te ketyre te punesuar ceken kontrata qe OE Loni ka qen cdo here OE kontraktues me AMKMK ku z.Mulaj eshte drejtor I prokurimit . AK-se nuk ka ndermarre asnje veprim mbi kete qeshtje te vertetimit te pikes ankimore nga ana jone si OE ankues. POR: NE SI OE PERMES EPROKURIMIT KEMI HASUR SE PAKU TRI KONTRATA AKTIVITE QE OE LONI SHPK I KA TE KONTRAKTUAR ME AK-SE AMKMK. gjeni te BASHKENGJITURA. PER KETE QESHTJE KEMI KERKUAR PERMES EMAIL SE A KONSIDEROHET KONFLIKT INTERESI KY RAST TE CILEN E KA PRAKTIKUAR Z MULAJ.

Përgjigje në Pretendimin 2 të OE “ALBI COMPANY” SH.P.K”- Eksperti shqyrtues thekson Hartimi i e dosjes të tenderit është kërkesës e nenit 27 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. dhe nenit 17 RRPP Ne përputhje me nenin 17 .12 të RRPP së 17.12 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë dhe ne njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit është kërkuar I certifikuar në PMP (Project Management Professional) nga Project Management Institute. Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të

prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Ekspert shqyrtues Thekson se ne dokumentet e Ofertës Grup i Operatorëve Ekonomik ART - EDA SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Hakif Zejnullahu Hoteli i Vetmuarve, Nr 4-1, 10000, Prishtinë, Kosovë te shpallur fitues Certifikatës se regjistrimit ne ARBK konstatohet se Besim Mulaj është pronar I kompanise. Z Mulaj nuk është drejtor I Prokurimit ne Komunën e Prishtinës ne vendin ku është përanditur Dosja e tenderit dhe Njoftimi për kontrate se bashku me Specifikat e Tenderit por është ne Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialëve te Kosovës AMKMK. Dhe Person i Autorizuar ne te njeten Certifikatës se regjistrimit ne ARBK Është Nysrt Dreshaj ku ka plotësimin e te gjitha dokumenteve te tenderit

Pas shqyrtimit të dosjes dhe të dhënave ne E-Prokurim : Z. Mulaj nuk ka pasur rol në përgatitjen e ofertës së GOE fitues dhe nuk ka pasur qasje në dokumentacionin ose njoftimet e kontratës. Dhe as nuk ka nënshkruar as një dokument te tenderit por këtë e ka bere Nysrte Dreshaj. Marrëveshjet e përdorimit të resurseve janë midis GOE fitues dhe LONI Shpk, jo me z. Mulaj si individ ose drejtor i AMKMK .Shfrytëzimi i resurseve të LONI Shpk: GOE fitues ka përdorur resurse të LONI Shpk përmes marrëveshjeve të ligjshme, si qira paisjesh ose shfrytëzim të kapaciteteve teknike, të përfshirë në procesin e tenderit. Dhe se Asnjëri nga punonjësit e LONI Shpk nuk ka pasur qasje në dokumentacionin e ofertës ose në informacion të brendshëm të procedurës 109“RENOVIMI I SHKOLLAVE FILLORE – Mbulimi i kulmit te rrafshet, renovimi i mureve te demtuara dhe riparimi i dyshemese te shkolles “Qamil Batalli”, me nr. të prokurimit: "616-25-4319-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES . dhe Konflikti i interesit sipas LPP-së: Konflikti ekziston kur zyrtari i AK-së mund të ndikojë në objektivitetin e tenderit për përfitim personal.

Në këtë rast, nuk ka prova për ndikim të drejtpërdrejtë ose qasje të privilegjuar të z. Mulaj në këtë tender. Përdorimi i resurseve të LONI Shpk nuk krijon konflikt interesi, sepse nuk ndikon në objektivitetin e procedurës.

Eksperti shqyrtues vlerëson se se fitimi i kontratave në një AK tjetër nuk pengon pjesëmarrjen në tenderë të pavarur, për sa kohë nuk ka përfshirje ose ndikim në procedurën aktuale. Dhe Pretendimi i ankuesit për konflikt interesi nuk mbështetet ligjërisht. Marrëveshja e përdorimit të resurseve të LONI Shpk nga GOE fitues është ligjore dhe transparente. Z. Mulaj nuk ka pasur ndikim në këtë tender, dhe nuk ka nënshkruar as një marrëveshje për tenderin 109“RENOVIMI I SHKOLLAVE FILLORE – Mbulimi i kulmit te rrafshet, renovimi i mureve te demtuara dhe riparimi i dyshemese te shkolles “Qamil Batalli”, me nr. të prokurimit: "616-25-4319-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES këtë e ka bere personi i autorizuar Nysrte Dreshaj dhe Partneri H & S Partners Group SH.P.K.: Sahit Ajazi dhe si përfundim

Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim i gjendet i PA BAZUAR

Pretendimi i 3 OE “"ALBI COMPANY" SH.P.K”- “ Pika ankimore nr 3

Sipas Informatave te kompanise tone z.Emir Bunjaku me profesion Inxhiner I Akitektures. Ku i njejt i ende vazhdon te punon ne NDERMARRJEN PUBLIKE BANESORE. Ku ndermarrja publike banesore NPB eshte ndermarrje publike e Komunes se Prishtines – Komuna e Prishtines eshte aksionar 100% e NPB, Ne si OE konsiderojme KONFLIKT INTERESI angazhimin z.

Emir Bunjaku-t nga kompania Art/Eda shpk per kete aktivitet prokurimit ku Kontraktues se aktiviytit eshte Komuna e Prishtines ku z. Bunjaku eshte I angazhuar si I punesuar Aktiv I Komunes se Prishtines, duke u bazuar se NPB eshte ndermarrje publike e Komunes Prishtines ecila I F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK 4/3 posedon 100 % aksionet e NPB. Eshte jo ligjore qe I punesuar aktiv I Komunes se Prishtines te angazhohet nga Gr OE fitues si I punesuar per aktivitetet e prokurimit/kontrate te Komunes se Prishtines . Kete pike keMi kerkuar nga Agjencia kunder Korrupsion qe ta vertetoje se a eshte konflikt interesi qe z Bunjaku

Përgjigje në Pretendimin 3 i OE “"ALBI COMPANY" SH.P.K”- “

Eksperti shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje te Tenderit dhe ne Njoftim per Kontrate ka kërkuar Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 68-69 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net> ku ka kërkuar 2. Operatori ekonomik duhet të prezantoj stafin e nevojshëm që do të angazhohen në këtë projekt si më 2.2. Së paku një Inxhinier i diplomuar ose master i Arkitekturës min. 4 vite përvojë punë pas diplomimit

Dëshmi 2. Një listë e stafit (e nënshkruar dhe e vulosur nga OE), bashkë me dokumentet përcjellse si më poshtë 2.1. deri 2.5 Dëshmi CV-ja mbi përvojen e punës, diplomat dhe çertifikatat kopje e noterizuar nga origjinali, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt (e nënshkruar dhe e vulosur nga punëdhënësi dhe punëmarrësi), 2.6. Dëshmi kontrata valide e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt.

Ankuesi ka pretenduar se z. Emir Bunjaku, Inxhinier Arkitekture dhe punonjës i NPB (Ndërmarrjes Publike Banesore – Komuna e Prishtinës), përbën konflikt interesi kur është angazhuar nga kompania fituese Grup i Operatorëve Ekonomik ART - EDA SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Hakif Zejnullahu Hoteli i Vetmuarve, Nr 4-1, 10000, Prishtinë, Kosovë për aktivitetin e prokurimit. Z. Bunjaku është angazhuar nga Partneri i Grupit H&S Partners SH.P.K., pjesë e GOE fitues. Dhe se Marrëveshja nuk është direkt me Komunën e Prishtinës ose NPB por me Grup i Operatorëve Ekonomik ART - EDA SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Hakif Zejnullahu Hoteli i Vetmuarve, Nr 4-1, 10000, Prishtinë, Kosovë. Z. Bunjaku nuk ka rol në vendimmarrjen e Komunës për tenderin dhe nuk ka qasje në procesin e vendimmarrjes Vlerësimi ligjor: Konflikti i interesit sipas LPP-së ekziston vetëm kur zyrtari i AK-së mund të ndikojë në vendimmarrje për përfitim personal. Në këtë rast, nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë ose përfitim personal, pasi z. Bunjaku vepron vetëm si staf teknik për kompaninë fituese dhe kontrata është me Partnerin e Grupit. Dhe s e Z. Bunjaku është i punësuar aktiv në NPB. Aktiviteti i prokurimit në fjalë është i lidhur me Komunën e Prishtinës e jo me NPB

Eksperti Shqyrtues thekson se Vlerësimi ligjor sipas LPP NENI 4 PARAGRAFI 1.75. -së dhe parimeve të konfliktit të interesit Konfliktet e interesit - çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit Në këtë rast: Z. Bunjaku është punonjës i NPB dhe nuk ka rol në vendimmarrjen e Komunës së Prishtinës për

këtë prokurim; Ai është thjesht një person teknik i angazhuar nga kompania fituese për ekzekutimin e kontratës; Nuk ka avantazh të padrejtë ose ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në vendimmarrjen e Komunës; Lidhja me NPB nuk e vendos z. Bunjaku në pozicion për të favorizuar kompania e tij në mënyrë të paligjshme. Angazhimi i z. Bunjaku nga kompania fituese për aktivitetin e prokurimit nuk cenon objektivitetin e tenderit.

Eksperti Shqyrtues Thekson se Konflikti i interesit sipas LPP-së ekziston vetëm kur zyrtari i AK-së mund të ndikojë në objektivitetin e tenderit për përfitim personal Asnjë nga rastet e paraqitura nuk krijojnë konflikt interesi sipas ligjit. Përdorimi i resurseve të kompanive partnere (H&S Partners SH.P.K.) është legjitim dhe nuk ndikon në vendimmarrjen ose objektivitetin e procedurës. Dhe si përfundim

Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim i gjendet i PA BAZUAR

Pretendimi i 4 OE “ALBI COMPANY” SH.P.K”- “Pika 4.. Dokumenti Marreveshje për qera të mjeteve dhe paisjeve I datës 04.06.2025 I lidhur ndërmjet anëtarit të grupit H&S Partners Group shpk dhe Gal Group shpk në asnjë nënë të marreveshjes nuk janë përshkruar se cilët Paisjet/Makinëri I kontraktohen Palet. Dokumenti Marreveshje për qera të mjeteve dhe paisjeve I datës 04.06.2025 I lidhur ndërmjet anëtarit të grupit H&S Partners Group shpk si huamarres dhe Loni shpk si huadhes në asnjë nënë të marreveshjes nuk janë përshkruar se cilët Paisjet/Makinëri I kontraktohen Palet.

Që si OE pretendojmë se këto marreveshje nuk përmbushin kushtin kontraktual ndërmjet huadhenesit dhe huamarresit sepse në cdo Marreveshje ndërmjet huadhenesit dhe huamarresit duhet përshkruhet se cila Paisje mirret me qira. Si argument OE fitues Art-Eda shpk në dokumentin LISTA E MAKINERISE DHE MJETEVE TË PUNES, STABILIMENTEVE DHE PAISJEVE TEKNIKE, ku në PIKEN 2 TË LISTES SE PAISJEVE ESHTË I përshkruar me Numer Tabelave KAMIONET volkswagen 01-7523-NL, ku për këto paisje ka ofruar Librezen e paisjes tjetër KAMIONET me Numer Tabelave 01-714-PM . KJO ARGUMENTON SE MARREVESHJA E DOREZUAR NGA GR OE FIUES NUK I PLOTESON KUSHTET KONTRAKTUALE LIGJORE NDERMJET HUADHENESIT DHE HUAMARRSIT Kushtet kontraktuale I nderuar z. Shehu Nese shkon tek NOTERI për ta bërë në kontratë mbi qirane e një lokali, Noteri nuk bëjnë asnjë marreveshje/kontratë kontraktuale ndërmjet huadhenesit dhe huamarresit PA PERCAKTUAR/ SPECIFIKUAR SE CILIN LOKAL JEPET ME QIRA. OE ENGINEERING – I Pika ankimore nr 1 PA PERGJEGJSHEM Kamioni me kran me nr

tab:06- 185-CU është me peshe mbartese 5.22 Ton , ndërsa në F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK 5/3 kerkese është kerkuar Pesha mbarese 7-9 Ton.- Po ashtu afati I regjistrimit nuk mund të shikohet sepse është I padukshëm

Përgjigje në Pretendimin 4 i OE “ALBI COMPANY” SH.P.K”- “

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje të Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë ku ka kërkuar Operatori Ekonomik, për realizimin e projektit duhet të ketë në pronësi ose të ketë marrëveshje për marrjen në shfrytëzimin, llojet e mjeteve dhe pajisjet teknike të punës si në vijim 3.1. Kamioneta - së paku 2 copë 3.2. Kamion me kran me peshe bartëse 7-9 ton - së paku 1 copë 3.3. Mjet vetëshkarkues (damper) min. 2 m3 - së paku 1 copë 3.4. Mjet ngritës me kovë për vend punishte – së paku 1 copë 3.5. Hillt për demolim – së paku 2 copë 3.6. Përzierse për ngjitës – së paku 2 copë 3.7. Thithëse elektrike – së paku 2 copë 3.8. Rrafshuese gleti – së paku 2 copë 3.9.

Makinë për ngjyrosje – së paku 1 copë 3.10. Shpuese betoni – së paku 2 copë 3.11. Nivelizues – së paku 1 copë 3.12. Paisje silikonit – së paku 2 copë

3. OE duhet të ofroj si dëshmi listën e paisjeve dhe mjeteve të punës, të nënshkruar dhe vulosur në origjinal. Për piken 3.1. deri 3.3 mjetet që regjistrohen, si dëshmi duhet të ofrohen kopje e librezes së qarkullimit valide. Për mjetet nga pika 3.4 deri 3.12 si dëshmi duhet të ofrohet faturen e blerjes me dëshmi pagese nga banka ose kontrate shitblerje ose deklaratën unike doganore - kopje të noterizuara nga origjinali për dëshmit e kërkuara Në rast se OE nuk posedon në pronësi mjetet dhe paisjet e punës në fjalë, duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen në shfrytëzim të pajisjeve me të gjitha dëshmit e kërkuara më lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti (e nënshkruar dhe e vulosur nga punëdhënësi dhe punëmarrësi.....

Ankuesi pretendon se marrëveshjet për qira të paisjeve (datë 04.06.2025) midis H&S Partners Group SHPK dhe Loni SHPK/Gal Group SHPK nuk përmbushin kushtet kontraktuale, pasi nuk specifikojnë secilën paisje veç e veç. Fakti real sipas dokumenteve të dosjes së tenderit (aktiviteti 109“RENOVIMI I SHKOLLAVE FILLORE – Mbulimi i kulmit të rrafshet, renovimi i mureve të demtuara dhe riparimi i dyshemese të shkolles “Qamil Batalli”, me nr. të prokurimit: "616-25-4319-5-2-1",); OE duhet të ketë në pronësi ose të ketë marrëveshje për marrjen në shfrytëzim të paisjeve dhe mjeteve të punës të kërkuara për projekt. OE ka dorëzuar marrëveshje të përgjithshme për shfrytëzim të pajisjeve Paisjet e kërkuara janë të dokumentuara në dosje të veçanta (“foldera”) me librezat përkatëse të regjistrimit. Marrëveshja nuk përshkruan secilën paisje veç e veç, por të gjitha paisjet e nevojshme janë të identifikueshme dhe të disponueshme për projekt. Numrat e librezave të paisjeve (p.sh., kamionët) janë të regjistruara në dosjet e veçanta dhe përputhen me paisjet e dorëzuara si dëshmi. Eksperti Shqyrtues Thekson se OE nuk e di ku ka marr pajisje që është e regjistruar me katër numra si psh(01-7523-NL) sepse kjo pajisje nuk gjendet në Ofertën e Grupit Ekonomik . Eksperti shqyrtues Thekson se Lloji i marrëveshjes së shfrytëzimit nuk humb vlefshmërinë ligjore vetëm sepse nuk përshkruan çdo pajisje veç e veç, për sa kohë OE demonstroi qasje të plotë në pajisjet për projektin. Marrëveshjet e përgjithshme të shfrytëzimit, të mbështetura nga dosjet individuale të paisjeve dhe librezat përkatëse, plotësojnë kërkesat kontraktuale të tenderit. Eksperti shqyrtues Thekson se marrëveshjet për përdorim/shfrytëzim të pajisjeve mund të jenë të përgjithshme, për sa kohë OE mund të demonstrojë disponueshmërinë e pajisjeve dhe përdorimin e tyre për projekt. Eksperti shqyrtues Thekson OE ka dokumentuar pajisjet në mënyrë të pranueshme dhe të verifikueshme për projektin. Marrëveshjet e përgjithshme mbulojnë përdorimin e pajisjeve për projektin. Dhe gjinden në folldera të veçanta me librezat e paisjeve ofrojnë dëshmi të qarta të pajisjeve që do të përdoren . dhe si përfundim Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim i gjendet i PA BAZUAR

Perfundim Pika 1 – Vertetimet nga Gjykata dhe administrata tatimore OE fitues ka dorëzuar dokumentet të kërkuara në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Pika 2 – Konflikti i interesit për pronarin/drejtorin në një AK tjetër Z. Besim Mulaj ka lidhje me OE fitues, por stafi i Loni SHPK përdoret për projekte të tjera dhe nuk ka pasur qasje apo ndikim në tenderin e objektit aktual. Marrëveshjet e përdorimit të resurseve janë të ligjshme dhe të ndara nga aktivitetet e AMKMK. Pika 3 – Angazhimi i stafit të punësuar në NPB Z. Emir Bunjaku është angazhuar përmes partnerit të grupit H&S Partners, jo direkt nga Komuna e Prishtinës. Nuk ka përfshirje në vendimmarrje ose kontroll të aktivitetit. Pika 4 – Marrëveshjet për qira të paisjeve Marrëveshjet midis H&S Partners dhe Loni/Gal Group mbulojnë përdorimin e paisjeve të nevojshme për projekt dhe janë të mbështetura nga dosje të veçanta me librezat e paisjeve. Dosja e tenderit lejon përdorimin e marrëveshjeve të përgjithshme për paisjet, për sa kohë ato janë të

verifikueshme.

Si përfundim OE fitues ka përmbushur të gjitha kërkesat e tenderit. Nuk ka prova që konfirmojnë konflikt interesi apo shkelje të kushteve të kontratës. Pretendimet e ankuesit nuk kanë bazë ligjore ose faktike dhe nuk mund të çojnë në refuzimin e ofertës së OE fitues. Procedura e shpërblimit të kontratës është e ligjshme dhe e drejtë.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues pa pasur nevojë që te njëjtat te perseriten. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit 109 Renovimi i Shkollave Filllore – Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli”, me numër të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "ALBI COMPANY" SH.P.K**
- Arkivës së OSHP-së: